



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 165, datë 15.04. 2020

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURAVE TË VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE FIGURËS SË
KANDIDATËVE PËR MAGJISTRATË PROKURORË, TË DIPLOMUAR NGA
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS NË VITIN AKADEMIK 2019 -2020**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa “a”, të Kushtetutës, në nenet 32, pikat 2-6, 35, pika 1, germa “c”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 159, pikat 1 dhe 2, germa “a”, 190, pika 2, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin nr. 171, datë 27.09.2019, e Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për miratimin e Rregullores për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe për zhvillimin e karrierës së prokurorëve”, me propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat e verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatëve për magjistratë prokurorë, të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës në vitin akademik 2019 -2020, si më poshtë:
 - 1.1 Z. Gazmend Frëngu
 - 1.2. Znj. Enkeleda Hoxha
2. Ngarkohet Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe Njësia e Mbështetjes së Komisioneve në Departamentin e Shërbimeve Ligjore për ndjekjen e këtij procesi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

**KRYETAR
GENT IBRAHIMI**


**ZV/KRYETARI
ALFRED BALLA**



**ANËTAR
KOSTAQ BELURI**



**ANËTAR
BUJAR SHESHI**



**ANËTAR
NURIHAN SEITI**



**ANËTAR
SANDËR BECI**



**ANËTAR
VATË STAKA**



**ANËTAR
TARTAR BAZAJ**



**ANËTAR
ESMERALDA KESHI**

